

# Anëtarët e KKSB-së akuzojnë Zyrën e Personelit për zvarritje mëditjesh

Arian Duriqi

LIPJAN, 6 MAJ – Këshilli komunal i sigurisë në bashkësi në Lipjan po rrezikon sërish funksionalitetin pikërisht për mungesë mëditjesh që nuk janë paguar për këtë organ prej kohësh, edhe pse kjo çështje është e rregulluar me një udhëzim administrativ nga MPB-ja para 9 muajsh. Mirëpo me gjithë thirrjen e vazhdueshme të anëtarëve të KKSB-së, mëditjet jo që nuk janë paguar, por as që parashihet diçka e tillë nga zyrtarët e Lipjanit, derisa për këtë zvarritje vetë anëtarët e KKSB-së po akuzojnë Zyrën e Personelit në këtë komunë. Madje Bekim Krasniqi, drejtor ekzekutiv në Asociacionin Rinor për të Drejtat e Njeriut (YAHR) drejtuesit e Zyrës së Personelit në Lipjan po i sheh të paaftë për kryerje detyrash. “Në interesimin e anëtarëve të KKSB-së pse nuk paguhen mëditjet del se fajet janë te Zyra e Personelit, për shkak se edhe Thesari tregon se mëditjet shkojnë nëpërmjet kësaj zyre, por që kjo zyrë duket se nuk ka aftësi të kryejë punët siç duhet dhe kështu rrezikon të mos mbledhë më KKSB-në, sepse puna vullnetare më nuk shkrepi”, ka thënë Krasniqi, i cili njëherësh përfaqëson OJQ-të në këtë organ. Ndërkohë që ka pasur edhe të tjerë anëtarë të KKSB-së në Lipjan, që nuk e shohin të arsyeshme pjesëmarrjen në qoftë se mëditjet nuk realizohen shpejt. Nazmi Bikliqi, përfaqësues në KKSB nga komuniteti turk, thotë se është e vështirë që një pjesë e anëtarëve të bëjnë shpenzime tjera për pjesëmarrje në mbledhjet e këtij organi. Ai është anëtar i këtij organi prej disa



**Nazmi Bikliqi përfaqësues në KKSB nga komuniteti turk, thotë se është e vështirë që një pjesë e anëtarëve të bëjnë shpenzime të tjera për pjesëmarrje në mbledhjet e këtij organi**

vjetësh dhe asnjëherë nuk është shpërblyer për pjesëmarrje e kontribut. Dhe meqë udhëzimi administrativ tashmë e rregullon këtë gjë, ai kërkon të realizohen të drejtat e anëtarëve. “Edhe pse në të kaluarën nuk kemi marrë mëditjet kemi qenë pjesëmarrës për shkak të kontributit që kemi dashur ta jepnim për sigurinë në komunë, mirëpo tashmë meqë kjo pjesëmarrje është e rregulluar edhe me ligj kërkojmë të drejtën tonë për pagesë mëditjesh”, ka thënë ai. E nga ana tjetër, autoritetet komunale derisa nga njëra anë kanë paqartësi për realizim të këtyre mëditjeve, nga ana tjetër nuk e dinë se kush është përgjegjës për kryerje obligimesh

ndaj anëtarëve të KKSB-së. Përderisa Petrit Kelmendi, drejtor në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave, thotë se dikasteri i tij është vetëm ekzekutues i pagesës dhe nuk merret me rregullim procedurash, nga ana tjetër Zyra e Personelit duke u përgjigjur nëpërmjet Zyrës së informacionit publik nuk ka marrë faj përsipër duke hedhur poshtë akuzat se kjo çështje ka të bëjë me ta. “Zyra e Personelit në përgjigjen që ka dhënë pikërisht për këtë çështje është deklaruar se nuk i kanë procesuar asnjëherë mëditjet të tilla, as më herët e as tashmë. Realisht thonë se nuk është çështje e tyre pagesa e mëditjeve”, ka thënë Hasan Luma, shef i ZIP-it në Lipjan.